



Nr. 4 Prot

Datë, 24.03.2020

VENDIM
Nr. 2, datë 24.03.2020

PËR

HAPJEN E PROCESIT TË REGJISTRIMIT TË KANDIDATËVE PËR DREJTUS TË NJËSISË KRYESORE, DREJTUES TË NJËSISË BAZË, PËR ANËTARËT E KOMISIONEVE TË PËRHERSHME NË NJËSINË KRYESORE NË FAKULTETIN E SHKENCAVE TEKNIKE NË UNIVERSITETIN "ISMAIL QEMALI" VLORË.

Në zbatim të Ligjit Nr.80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", në zbatim të nenit 7 pika 6/d, nenit 18, pika 3, të Vendimit të Senatit Akademik Nr.59, datë 11.02.2020 "Për miratimin e Rregullores për organizmin e zgjedhjeve për autoritetet dhe organet drejtuese në Universitetin "Ismail Qemali" Vlorë; Vendimit Nr.1, datë 18. 03. 2020 "Për shpalljene e fituesit të Kryetarit të Komisionit Zgjedhor pranë Fakultetit të Shkencave Teknike (KZF).

Komisioni Zgjedhor i Fakultetit:

VENDOSI:

1. Të miratojë hapjen e procesit të regjistrimit të kandidatëve për Drejtus të Njesisë Kryesore, Drejtues të Njesisë Bazë, për Anëtarët e Komisioneve të Përhershme në Njësinë Kryesore në Fakultetin e Shkencave Teknike në Universitetin "Ismail Qemali" Vlorë.
2. Të miratojë periudhën kohore të regjistrimit të kandidatëve datën 28.03.2020, deri në datën 01.04.2020, brenda orarit zyrtar 8:00-16:00.
3. Procesi i regjistrimit kryhet kur kandidati paraqitet personalisht në zyrën e Komisionit Zgjedhor të Fakultetit për të depozituar dokumentacionin për kandidim. Pas regjistrimit, kandidatit i jepet vërtetimi i regjistrimit si kandidat nga Komisioni Zgjedhor i Fakultetit.
4. Vendimi publikohet në të gjitha mjediset e Fakultetit të Shkencave Teknike në Universitetin "Ismail Qemali" Vlorë dhe në sitin zyrtar www.univlora.edu.al.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Kryetar i Komisionit Zgjedhor të Fakultetit
Elmira Kushta

Anëtarët

Alma Sheko
Alba Rustemaj